



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
REKTORATI

Nr. 440 prot

Korçë, më 01/03/2024

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
THIRRJE PËR PROJEKTE TË KËRKIMIT SHKENCOR TË FINANCUARA
NGA TË ARDHURAT E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"
VITI 2024

- Fokusi** Universiteti "Fan S. Noli" shpall Thirrjen për projektpropozime në fushën e kërkimit, me fokus rritjen e ndikimit të kërkimit në zhvillimin e qëndrueshëm rajonal.
- Qëllimi** Thirrja shpallet në kuadër të nismës së Universitetit për planveprimin e përcaktuar në Objektivin 6 të Kërkimit shkencor në Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit "Fan S. Noli" 2002-2027, duke synuar:
- rritjen e ndikimit të ekspertizës së specializuar të Universitetit në rajon në fushat e ekonomisë, bujqësisë, edukimit, teknologjisë së informacionit, shkencave humane, shkencave të natyrës dhe shkencave të shëndetit;
 - vënien e kërkimit shkencor të aplikuar në dispozicion të zhvillimit rajonal;
 - promovimin e këtij të fundit në një rrjet më të gjerë kërkuesish rajonalë/ kombëtarë/ ndërkombëtarë;
 - ofrimin e shërbimeve për palë të treta në rajon.
- Financimi** Financimi i përgjithshëm në dispozicion për këtë thirrje është **3.000.000ALL**.
Kostoja minimale e një projektpropozimi është **1.000.000ALL**.
Për projektet me kosto më të larta financiare se buxheti i parashikuar, njësitë duhet të sigurojnë bashkëfinancim nga burime të tjera të jashtme (kryesisht palë interesi në treg).
- *Detajimet e zërave të buxhetit kryhen sipas nenit 5 të Rregullores për procedurën për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të financuara nga të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli"*
- Kohëzgjatja** Deri në **7 muaj** nga data e miratimit të projektit.
- Veprimtaritë** Studime në terren, studime në laborator, kërkime empirike, kërkime në arkiva, aktivitete shkencore kuadër, botime, përmirësim infrastrukture kërkimore lidhur me sa më sipër, rritje kapacitetesh të burimeve njerëzore në kërkim.

Aplikuesit	Koordinatori i projektit duhet të jetë specialist i fushës për të cilën hartohet projekti. Grupi i punës përfshin së paku 4 (katër) staf akademik/administrativ/ personel ndihmësakademik/ studentë; në përbërje mund të ftohen edhe përfaqësues të palëve të interesit, apo institucioneve partnere.
Kritere për vlerësim	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përputhja e objektivave të projektpropozimit me fushat kërkimore institucionale dhe domethënia shkencore e projektit. 2. Qartësia e objektivave dhe pasqyrim i drejtpërdrejtë i veprimtarive kërkimore të parashikuara. 3. Ndikimi i kërkimit të aplikuar në zhvillimin e qëndrueshëm rajonal/kombëtar/ ndërkombëtar. 4. Lidhja e përditësimit të infrastrukturës së parashikuar në projekt me të drejta përdorimi edhe nga palë interesi jashtë universitetit. 5. Ndërhyrje e justifikuar në përditësimin e infrastrukturës laboratorike dhe angazhimin e stafit të kualifikuar në të. 6. Kualifikimi dhe ekspertiza e koordinorit dhe anëtarëve të projektit. 7. Kostoja dhe vlera e veprimtarive të parashikuara, buxheti transparent.
Afatet	<ul style="list-style-type: none"> - Rektorati organizon seancë informimi në lidhje me thirrjen dhe projektidetë në datën, 12 mars 2024, ora 12:30, Auditori R31. - Projektpropozimet dorëzohen në format shkresor dhe Pdf pranë Zv/rektorit për Shkencën dhe Projektet (si dhe rektorati@unkorce.edu.al) deri në datën 29 mars 2024. - Projektet fituese shpallen deri në 19 prill 2024. - Kohështrirja e veprimtarive të projektit parashikohet deri në nëntor 2024. - Raportimet mbi ecurinë e projektit hartohen dhe dorëzohen si më poshtë në mes dhe në fund të zbatimit të projektit.
Formati i raportimit	<ul style="list-style-type: none"> - Dosja e projektpropozimit detajohet sipas përcaktimeve në <i>Rregulloren për procedurën për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të fiancuara nga të ardhurat Universitetit "Fan S. Noli"</i> - Projekti dorëzohet sipas Formatit I bashkëngjitur Rregullores së sipërpëmendur. - Vlerësimi i dosjes së projektpropozimit kryhet sipas kritereve të cilësisë të përcaktuara në Formatin II. - Raportimi periodik dhe përfundimtar detajohet sipas Formatit III dhe IV.

Prof.dr. Dhimitri Bello
Rektor

